

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-220/11**

**Prishtinë, 4 qershor 2012**

Në çështjen juridike të:

**A.S.**

***Pala ankuese***

Kundër.

**B.M.**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/83/2010 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA17887), të datës 2 shtator 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 4 qershor 2012, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. **Pranohet si e bazuar ankesa e A.(S.)S..**
2. **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/A/83/2010, i datës 2 shtator 2010, dhe lënda kthehet për rishqyrtim.**
3. **Për shpenzimet e procedurës do të vendoset nga KPKK-ja.**

### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

Me 26 janar 2007, B.M. (paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) si anëtar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 69 me sipërfaqe prej 3 ha, 13 ari e 80m<sup>2</sup>, e përshkruar si arë që ndodhet në Komunën e Vushtrrisë në zonën kadastrale të Hercegovës. Paraqitësi i kërkesës “ka vërtetuar” se e drejta e tij pronësore ka të bëjë me pronën e paluajjtshme private që ishte humbur si rezultat i rrethanave të vitit 98/99 në Kosovë dhe se datat e humbjes ishte 12 qershori 1999.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë si fëmija i bartësit të së drejtës pronësore M.M..

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ia ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme:

- a) kopjen e fletës poseduese nr. 39, të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Vushtrrisë, komuna kadastrale e Hercegovës, më 15 tetor 1997;
- b) një plan të vizatuar me dorë që jep informacionet për lokacionin e pronës në vendin Hercegovë, të nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës dhe zyrtari i AKP-së;
- c) Kopjen e letërnjoftimi të B.M.;
- d) Certifikatën e vdekjes të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e Vushtrrisë, më 25 janar 2008, që tregon se M.M., me vendbanim dhe adresë të përhershme në Pantinë të Vushtrrisë, kishte vdekur më 22 maj 1969 në Pantinë të Vushtrrisë.

Faktet lidhur me procedurën para AKP-së

Në kërkesën e tij të datës 26 janar 2007, paraqitësi i kërkesës thekson se ai nuk e din se kush ka qenë duke e shfrytëzuar pronën dhe se procedura e trashëgimisë nuk ishte zhvilluar.

Zyrtarët e AKP-së për njoftim kanë shkuar në pronën e kërkuar me 6 mars 2009 dhe kanë gjetur se prona ishte një arë e papunuar.

Më 5 shkurt 2010, zyrtarët e AKP-së kanë kryer njoftimin e dytë në vendin ku supozohej se ndodhej ngastra dhe kanë vendosur një shenjë që tregon se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të paraqisnin përgjigjen e tyre brenda një muaji. Në raportin e njoftimit të datës 5 shkurt 2010, AKP-ja ka vërejtur se ngastra kontestuese ishte një arë e kultivuar – nuk është sqaruar se si është nxjerrë ky përfundim, me 5 shkurt 2010 toka ishte e mbuluar me borë (siç është e dukshme nga fotografia e bërë nga zyrtarët e AKP-së kur e kanë vendosur shenjën e notifikimit). Raporti tregon se prona ishte gjetur në bazë të të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe pasi që prona është gjetur e shfrytëzuar, ekipi i njoftimit ka bërë përpjekje që të identifikojë personin që shfrytëzonte pronën për pa sukses sepse banorët vendas nuk ishin aq bashkëpunues për të treguar personin që ishte duke shfrytëzuar pronën.

Më 18 shkurt 2010, AKP-ja ka nxjerrë një raport për të konfirmuar se njoftimi i pronës së kërkuar ishte bazuar saktësisht në të dhënat kadastrale siç janë ortofotot dhe koordinatat e gps-it.

Në raportin e procesimit të kërkesës drejtuar KPKK-së me 21 qershor 2010, është përmendur se asnjë palë përgjegjëse nuk është paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive për të kontestuar kërkesën para skadimit të afatit të paraparë prej 30 ditëve dhe se certifikata e vdekjes dhe letërnjoftimi të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës janë verifikuar pozitivisht. Sekretaria Ekzekutive është e mendimit se humbja e posedimit ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 që ndërlidhet me konfliktin e armatosur në Kosovë.

Më vendimit grupor KPKK/D/A/83/2010, KPKK-ja ka pranuar se në 283 kërkesa, të identifikuara në pjesën E të Shtojcës së bashkëngjitur (nuk gjendet në lëndën aktuale), paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar pronësinë. Pas vendimit përcjellës të datës 10 dhjetor 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka nxjerrë një vendimi individual në emër të paraqitësit të kërkesës për identifikimin e pronës së kërkuar. De jure KPKK-ja ka vendosur se paraqitësi i kërkesës kishte vërtetuar se M.M. (babai paraqitësit të kërkesës) është pronar i 1/1 të pronës së kërkuar dhe se B.M. (paraqitësi i kërkesës) kishte të drejtën e posedimit të pronës në fjalë dhe se çdo person që kishte uzurpuar pronën duhej ta lironte atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dorëzimi i vendimit. Komisioni kishte vendosur po ashtu që në rastin kur ka më tepër së një pronar të pronës së kërkuar, vendimi dhe urdhëri i lartpërmendur nuk ndikon në të drejtat e ndonjë bashkëpronari përkatës.

Vendimi i KPKK-së i ishte dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 15 mars 2011.

Më 17 nëntor 2011, A.S. (tani e tutje ankuesi) ka paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartpërmendur. Ai ka sqaruar se e kishte trashëguar pronën nga babai i tij S.(H.)S., i cili e kishte blerë pronën nga M.M. në vitet e 70-ta, dhe më vonë kjo pronë kishte qenë objekt i komasacionit, ku prona iu ishte bartur atyre. Si dëshmi ankuesi ka paraqitur një kopje të planit e cila tregon se ngastra nr. 69 është nën komasacion dhe kopjen e vendimit për ndarje e tokës nga komasacioni, të datës 4 prill 1988.

Paraqitësi i kërkesës, nëpërmjet avokatit të tij ka paraqitur një përgjigje me shkrim më datën 19 dhjetor 2011, e cila është pranuar nga AKP-ja me 7 shkurt 2012, që cek se paraqitësi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë provë se e kishte trashëguar pronën nga babai i tij e cili e kishte blerë pronë në 70-ta nga M.M. dhe se “vendimi për ndarjen e tokës nga komasacioni” nuk përmbante ndonjë vulë apo nënshkrim të vendimmarrësit në fjalë. Ai ka propozuar që ankesa të refuzohej si a pabazuar dhe pala ankuese të urdhërohet të kompensojë shpenzimet e paraqitjes së përgjigjës në ankesë.

Me urdhërin e datës 15 shkurt 2012, Kolegji i Apelit të AKP-së ka kërkuar nga pala ankuese që të paraqes dëshmi se ai është pasardhës (i biri) i S.(H.)S.; të paraqes informacionet rreth adresës së tij aktuale; të sqaroj nëse ai pohon se ngastra 13 (13k-0) sipas planit aktual kadastral korrespondon me ngastrën 69, të kërkuar nga paraqitësi i kërkesës/pala përgjegjëse në ankesë dhe nëse ai nuk ishte njoftuar rreth kërkesës së paraqitësit të kërkesës; nëse ishte njoftuar për kërkesën e paraqitësit të kërkesës, çfarë e kishte parandaluar atë që të përgjigjet në kërkesë brenda periudhës kohore prej 30 ditëve.

Më 16 mars 2012, pala ankuese ka paraqitur një përgjigje me shkrim, ku sqaron se ngastra 13k ishte krijuar nga ngastra e mëhershme 69 në sipërfaqen prej 2 hektarëve, ndërsa pjesa tjetër e ngastrës 69 duhej të ishte në pronësi të kushëririt të tij P.S. dhe se **ai asnjëherë nuk ishte informuar nga dikush për kërkesën lidhur me një pjesë të tërë ngastrës së tij. Ai pohon se nuk e kishte parë këtë kërkesë të paraqitur në ngastrën e tij pasi që ai nuk jeton aty afër e as që e punon fare ngastrën.** Për të ishte befasi se si as bashkëfshatarët tij e as kushëriri i tij P.S. që kishte paguar qira dhe e kishte punuar ngastrën që nga viti 1999 nuk e kishin parë informacionin. Pala ankuese po ashtu paraqiti një certifikatë të vendbanimit të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës me 10 shkurt 2009, certifikatën e vdekjes së S.S. të lëshuar nga Komuna e Mitrovicës me 15 mars 2012, certifikatën e lindjes të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë me 5 shkurt 2009, që dëshmojnë e ai është i biri i S.S. dhe letërnjoftimin nga komuna e njëjtë të lëshuar me 26 gusht 1993.

Me letrën e datës 2 mars 2012 nga avokati i palës përgjegjëse në ankesë, AKP-ja ishte informuar se pala përgjegjëse në ankesë kishte iniciuar procedurën për vërtetimin e së drejtës pronësore kundër D.R. nga Zveçani në Gjykatë Komunale të Mitrovicës (një kopje e padisë së datës 1 mars 2012 është bashkëngjitur) lidhur me një kopje të fletës së bashkëngjitur poseduese 126 të lëshuar nga Republika e Serbisë, Komuna e

Vushtrrisë, komuna kadastrale e Hercegovës, më 15 dhjetor 2011. Kjo padi ka të bëjë me ngastrën nr. 97 me sipërfaqe prej 62 ari e 76m<sup>2</sup>, e përshkruar si arë e klasës së 3-të në vendin e quajtur Zare në Komunën e Vushtrrisë, zona kadastrale e Hercegovës. Këto të dhëna dhe dokumentet e përshkruara janë të parëmdësishme për rastin aktual, kështuqë Gjykata nuk bënë ndonjë shqyrtim të tyre.

Me anë të urdhërit të lartpërmendur gjyqësor, të datës 15 shkurt 2012, AKP-së i është kërkuar që të sqarojë:

- a) nëse AKP-ja ka marrë parasysh ndonjë ndryshim të mundshëm në gjendjen kadastrale të pronës kontestuese për përuhdën 1988 deri në kohën e marrjes së vendimit të atakuar dhe
- b) nëse Sekretaria e AKP-së ka verifikuar planin aktual kadastral se në emër të kujt është regjistruar prona kontestuese dhe
- c) nëse sipas planit aktual kadastral, ngastra kontestuese nr. 69 më sipërfaqe prej 3 hektarëve, 13 ari e 80 metra katrorë (siç përshkruhet në fletën poseduese të vitit 1997 dhe fletën poseduese të vitit 2008) korrespondon me parcelën 13/13k-0, me sipërfaqe të panjohur dhe sa është sipërfaqja e kësaj të fundit.

Më 20 prill 2012, AKP-ja ka paraqitur dokumentet dhe sqarimet plotësues si në vijim:

- a) memorandumit ligjor nga Eksperti Kadastral që i referohet kërkesë KPA17887, të datës 29 shkurt 2012 e cila ndër të tjera thekson se “Të dhënat e paraqitura nga A.S. dhe P.I. tregojnë se ngastra 69 ishte përfshirë në komasacion. Vendimi i datës 4 prill 1988 tregon se ngastra 69 ishte përfshirë në komasacion dhe se pas këtij vendimi ajo ishte bartur në ngastrën nr. 13k dhe 14k, të cilat ishin kontestuar nga palët përgjegjëse në kërkesë A.S. dhe P.(T.)I.. Ngastra 13k ka një sipërfaqe prej 1, 59.85 ari dhe ngastra 14k ka një sipërfaqe prej 2,13.80 ari, ndërsa ngastra 69 para komasacionit kishte një sipërfaqe prej 3, 18.80 ari, dhe po ashtu ngastra 101 para komasacionit kishte një sipërfaqe prej 3,67.70, që ishte në pronësi të Kooperativës Bujqësore në Vushtrri; pas komasacionit kufijtë e këtyre ngastrave ishin ndryshuar dhe pjesët e ngastrave 69 dhe 101 i përkasin ngastrave 13k dhe 14k” dhe se “Në bazë të të dhënave dhe studimit të kryer nga ekspertët kadastral të Zyrës Rajonale të Mitrovicës dhe Zyrës Qendrore në Prishtinë, **është konfirmuar se njoftimi i bërë më 05.02.2010 nuk përputhet me statusin dhe lokacionin aktual të pronës së kërkuar**”;
- b) planin kadastral nga Agjencia Kadastrale e Kosovës;
- c) hartën e uebit duke përfshirë koordinatat e GPS-it të marra në kohën e njoftimit;
- d) procesverbalin e verifikimit të gjendjes faktike në emër të P.T.S., të datës 23 maj 1984 ku P.T.S. ka thënë se e kishte blerë ngastrën nr. 69 sipas fletës poseduese nr. 39 nga pronarja e mëhershme M. S.(e veja e M.) dhe se ai nuk posedonte ndonjë kontratë për këtë dhe se e kishte shfrytëzuar atë pa papengesë që nga viti 1974;

- e) procesverbalin e verifikimit të gjendjes faktike në emër të S.H.S., të datës 21 maj 1984 ku S.H.S. ka thënë se e kishte blerë ngastrën nr. 69 sipas fletës poseduese nr. 39 nga pronarja e mëhershme M.S. (e veja e M.) dhe se ai nuk posedonte ndonjë kontratë për këtë dhe se e kishte shfrytëzuar atë pa papengesë që nga viti 1975;
- f) Vendimin mbi komasacionin, të datës 04 prill 1988.

### **Arsyetim ligjor:**

Neni 10.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thekson: “Pas pranimit të kërkesës, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë”.

Neni 11.3 (c) dhe (d) po aty parasheh se KKKP-ja ndërmerr masa të tjera procedurale që i konsideron të duhura për të përshpejtuar vendimmarrjen.

Neni 11.1 po aty parasheh se dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative zbatohen përshtatshmërisht për procedurat e KKKK-së, përveç nëse parashihet ndryshe me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 thekson dhe me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5 për implementimin e Rregullores.

Neni 12.1 po aty parasheh se ankesa kundër vendimit të KKKP-së duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga njoftimi i bërë nga Agjencia Kosovare e Pronës.

Në rastin aktual, pala ankuese nuk është njoftuar rreth vendimit të lartpërmendur, për shkak se nuk kishte cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë në procedurën para AKP-së në përputhshmëri me nenin 10.1.

Kjo ka ndodhur sepse ankuesi nuk ishte në dijeni të zhvillimit të procedurës para AKP-ës, siç edhe thekson. Ky pohim është pranuar nga ana e Gjykatës si i bazuar duke pasur parasysh faktin se ankuesi nuk jeton në afërsi të pronës, dhe se ai nuk e mbjell dhe as nuk e punon. **Prandaj, afati prej 30 ditëve i parapraë ne nenin 12.1 po aty për paraqitje të ankesës nuk mund të konsiderohet se ka skaduar për palën ankuese, prandaj ankesa është e pranueshme.**

Neni 13.2 po aty parasheh se Gjykata Supreme e Kosovës, sipas rregullit, vendos mbi ankesën bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjykatë dhe të shqyrtuara nga KKKK-ja.

Neni 12.11 po aty parasheh se faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Nëse faktet dhe dëshmitë e tilla materiale pranohen, Gjykata Supreme mund të kërkojë vlerësimin dhe vrojtimin e Komisionit për këtë.

Pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën para AKP-së, provat e paraqitura nga ai para Gjykatës Supreme duhet të konsiderohen si të pranueshme sipas nenit 12.12 po aty (shkalla e parë). Sipas të njëjtit nen, fjalia 2, Komisioni ka dhënë vlerësimin dhe vërejtjet e tij.

Neni 39.2 i Ligjit për Procedurën Administrative – Ligji nr..02/L-28 parasheh se pavarësisht nga përmbajtja e paragrafit 1 të këtij neni dhe për aq sa është e mundur, organet e administratës publike duhet t'i korrigjojnë vetë kërkesat e palëve të interesuara, duke mos i dëmtuar interesat ligjore të palëve të interesuara. Ky formulim është manifestim i parimit të ligjshmërisë, siç përcaktohet në nenin 3.1 po aty, sipas të cilit organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Një manifestim tjetër i parimit të ligjshmërisë i cili është relevant në rastin aktual është ai i formuluar në nenin 3.2 po aty i cili thekson se organet e administratës publike sigurojnë zbatimin e akteve administrative të tyre, vendimeve përputhshmërisht, siç emërtohen aktet e KKKK-së.

Neni 55 po aty gjithashtu parasheh që organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara me Ligj. Ky formulim rrjedh sistematikisht nga parimi i objektivitetit të procesit administrativ konform nenit 7.1 po aty: “Gjatë veprimtarisë administrative, organet e administratës publike marrin në konsideratë dhe u japin peshën që u takon të gjithë faktorëve që lidhen me një akt të caktuar administrativ”. Po në të njëjtën linjë është neni 53.1 po aty i cili thekson se gjatë procedimit administrativ, nëpunësi që drejton procedimin merr në konsideratë të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen në fjalë dhe i jep secilit faktor vlerësimin e duhur.

Në rastin aktual, KKKK-ja ka marrë vendimin e saj në kundërshtim me parimet e objektivitetit, pa i marrë parasysh të gjithë faktorët që ndërlidhen me marrjen e vendimit.

Siç është cekur në “memorandumin e saj ligjor” të datës 29 shkurt 2012, AKP-ja sqaron se “Të dhënat e paraqitura nga A.S. dhe P.I. tregojë se ngastra 69 ishte përfshirë në komasacion. Vendimi i datës 4 prill 1988 tregon se ngastra 69 ishte përfshirë në komasacion dhe se pas këtij vendimi ajo ishte bartur në ngastrën nr. 13k dhe 14k, të cilat ishin kontestuar nga palët përgjegjëse në kërkesë A.S. dhe P.(T.)I.. Ngastra 13k ka një sipërfaqe prej 1, 59.85 ari dhe ngastra 14k ka një sipërfaqe prej 2,13.80 ari, ndërsa ngastra 69 para komasacionit kishte një sipërfaqe prej 3, 18.80 ari, dhe po ashtu ngastra 101 para komasacionit kishte një sipërfaqe prej 3,67.70, që ishte në pronësi e Kooperativës Bujqësore në Vushtrri; pas komasacionit kufijtë e këtyre ngastrave ishin ndryshuar dhe pjesët e ngastrave 69 dhe 101 i përkasin ngastrave 13k dhe 14k”. Ngastra 101 nuk është objekt i këtij kontesti por më sa duket informacionet që kanë të bëjnë më të janë relevante për objektin e kontestit sepse ngastrat e reja 13k dhe 14k janë të ngjitura me njëra tjetrën, siç mund të shihet nga të dhënat kadastrale. Konkludimet e vetme faktike që mund të bëhen janë se numrat 69 dhe 101 nuk reflektojnë gjendjen aktuale kadastrale dhe komasacionit të vitit 1988 kur edhe ishin krijuar ngastra të reja (ose përmes bashkimit ose nënndarjes); dmth. ato që kanë qenë në vitin 1988 si ngastrat 69 dhe 101 janë transformuar në njësi të reja kadastrale me numra të rinj – siç sqaron AKP-ja pjesa e 69 dhe 101 tani i përkasin 13k dhe 14k. Përfundimi ligjor i kësaj është se e drejta pronësore mbi ngastrën 69 është bartur në të drejtë pronësore ose në tërë ngastrën ose në pjesët ideale të ngastrave tjera, varësisht nga fakti nëse 69-shi i është dhënë vetëm emri i ri ose nëse është “absorbuar” (që është ajo që nënkuptohet në “memorandumin ligjor” në dy ose më tepër njësi të ndryshme kadastrale (nënkuptimi i përmendur rrjedh nga deklarimi se pjesa e 69-shit i përket tani 13k). Përveç kësaj, AKP-ja pranon se “njoftimi i i bërë me 05.02.2010 nuk përputhet me statusin dhe lokacionin aktual të pronës së kërkuar”.

Në këtë drejtim, KPKK-ja duhet të hulumtojë gjendjen aktuale kadastrale (konform parimit të objektivitetit), që përfshin historikun kadastral të tokës e cila njëherë është individualizuar si ngastra 69 dhe sipas detyrës zyrtare (konform parimit të objektivitetit – nenin 3.1 në lidhje me nenin 39.2 të Ligjit për Procedurën Administrative – Ligji nr. 02/L-28) të korrigjojë kërkesën në mënyrë që të reflektojë gjendjen aktuale kadastrale të pronës së kërkuar dhe dëshirën e paraqitësit të kërkesës. Pasi që kjo nuk është bërë gjatë procedurës para AKP-së, KPKK-ja ka marrë një vendim i cili nuk mund të implementohet, i cili paraqet një shkelje tjetër të parimit të ligjshmërisë (shih nenin 3.2 po aty). Kjo do të thotë se në pjesën ku vendimi i KPKK-së thekson se palët e treta duhet ta lirojnë pronën, vendimi nuk është i ekzekutueshëm, nuk ka identifikim të kufijve, nuk ka numër aktual kadastral për të përcaktuar se cilën pjesë të tokës duhet ta lirojnë palët e tretat përkatëse. Më qëllim që vendimi të jetë i zbatueshëm/ekzekutueshëm, ai duhet t’i referohet një pjese të tokës që është e dallueshme nga pjesët fqinje – me një numër unik (numrin aktual që pasqyron planin aktual. Në rast të mungesës së qartësisë lidhur me kadastrin aktual atëherë kufijtë dhe pikat e kufijve do të ishin të domosdoshëm). Në këtë drejtim, legjislacioni kadastral duhet të merret parasysht. Psh.: sipas nenit 2, para 2.9 të Ligjit nr. 2003/25 për Kadastrin (04 dhjetor 2003), të ndryshuar me Ligjin. nr. 02/L-



96 (26 janar 2007, të zëvendësuar me Ligjin nr. 04/-L-013 (29 korrik 2011) që është në fuqi dhe i zbatueshëm në kohën në kohën e procedurës para AKP-së), ngastra kadastrale është një pronë tokësore e formuar nga kufijtë dhe pikat e kufirit, që ndodhet brenda një zone kadastrale dhe e regjistruar në Kadastër si ngastër tokësore me një numër unik.

Përveç kësaj, komasacioni që është bërë sipas Ligjit për komasacionin (GZ e KSAK-së 31/1857) dhe ndryshimi i kadastral të cilit i referohet “memorandumit ligjore” krijon përshtypje se konteksti lidhur me pjesën e tokës të përfshirë në ngastrën 69 mund të ketë ndodhur shumë kohë para konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999. Ajo që dihet deri më tani është se ka pasur një komasacion në vitin 1998 dhe se ka pasur në ndryshim kadastral. Nuk dihet se kur është bërë ndryshimi kadastral dhe nëse bartësi i së drejtës pronësore e kishte humbur pronësinë si rezultat i komasacionit dhe/apo ndryshimit kadastral, apo më vonë si rezultat i konflikt të viteve 1998/1999. Siç përcaktohet në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 (neni 3.1) njëri prej kushteve për pranueshmërinë e kërkesës sipas këtij mekanizmi specifik procedural, është që kërkesa të jetë e ndërlidhur me rrethanat që rezultojnë nga konflikti i armatosur e jo për shkak të ndodhjes së fakteve, që nuk janë të ndërlidhura ose që nuk rezultojnë nga konflikti.

Vendimi i KKPK-së që për nga natyra nuk është i implementueshëm ngjason në një akt të pavlefshëm administrativ (neni 91 në lidhje me nenin 92 (d) po aty), ai është marrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Procedurën Administrative, dhe është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të procedurës administrative. Një akt i pavlefshëm administrativ në hipotezën e pavlefshmërisë absolute nuk prodhon ndonjë pasojë ligjore dhe nuk ka nevojë për revokim – argumenti sipas nenit 93.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Mjafton që një akt i tillë të deklarohet i pavlefshëm – argumentin sipas nenit 93.3 po aty. Megjithatë, duke marrë parasysh se Kolegji i Apelit të Gjykatës Supreme të Kosovës zbaton instrumentet procedurale të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe përputhshmërisht në Ligjin për Procedurën Kontestimore, Paneli anulon vendimin dhe ia kthen atë për rishqyrtim AKP-së.

Gjatë procedurës së re, AKP/KKPK-ja duhet:

- të hulumtojë (sipas nevojës, sa më shumë që të jetë e mundur) nëse posedimi i pronës ishte humbur si rezultat i konfliktit apo para kësaj si rezultat i një vargu faktesh dhe rrethanash tjetra;
- të korrigjojë kërkesën në mënyrë që ajo të reflektojë gjendjen aktuale kadastrale të pronës kontestuese dhe kërkesën e paraqitësit të kërkesës;
- të vlerësojë nëse bartësi i së drejtës pronësore ka qenë në posedim (sepse është kërkuar ri-posedimi, sipas kërkesës) të ngastrës kontestues dhe nëse po

- nëse paraardhësi i palës përgjegjës e kishte fituar të njëjtën pronë në vitin the 1988, si rezultat i procesit të komasacionit, i cili është kryer sipas Ligjit për komasacionin (GZ e KSAK-së 31/1857), me fjalë tjera cili ka qenë efekti i komasacionin lidhur me të drejtën pronësore mbi ngastrat, të cilat kanë qenë subjekti i komasacionit.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Lidhur me shpenzimet e procedurës para GJS-së, pasi që vendimi i kundërshtuar është anuluar dhe lënda është kthyer për rishqyrtim, shpenzimet e procedurës do të vendosen nga shkalla e parë (neni 465.3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore).

### **Udhëzim juridik:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim nuk mund të kundërshtohet me anë të mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike

*Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX*

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it*

*Urs Nufer, Referent i EULEX-it*